

# **INFORMATË PERIODIKE (ALTERNATIVE) E AVOKATIT TË POPULLIT DREJTUAR KOMISIONIT EVROPIAN KUNDËR RACIZMIT DHE JOTOLERANCËS (KERJ)**

## **I. Hyrje**

Avokati i Popullit, si organ me përvojë dhe praktikë shumëvjeçare në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, përmes kësaj Informatë Periodike ka për qëllim të kontribuoj sipas shkresës/kërkesës tuaj të datës 27.06.2018, në lidhje me hapat e ndërmarra nga autoritetet e Republikës së Maqedonisë për implementimin e rekomandimeve urgjente që kanë të bëjnë me Raportin e Komisionit Evropian Kundër Racizmit dhe Jotolerancës (KERJ) të rrethit të pestë të vëzhgimit, të miratuar më datë 18 mars të vitit 2016.

Në Informatë janë prezantuar gjendjet të cilat burojnë nga fushëveprimi i punës së Avokatit të Popullit, nga data e miratimit të Raportit deri në muajin gusht të vitit 2018. Kjo Informatë Periodike (Alternative) është përpiluar në përputhje me fushëveprimin e punës, parashtresat e pranuar dhe punën me lëndë të Avokatit të Popullit në pjesën e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve kur të njëjtat cenohen nga organet e administratës shtetërore/sectorit publik, lidhur me trajtimin diskriminues dhe moszbatimin e parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, si dhe mbi bazë të hulumtimeve individuale në fusha të caktuara.

Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë pret që kjo Informatë të ndihmojë në krijimin e imazhit të vërtetë për Republikën e Maqedonisë në zbatimin e rekomandimeve të rrethit të pestë të evaluimit të shtetit tonë, të cilat kanë të bëjnë me gjendjet me racizmin dhe jotolerancën. Në këtë kontekst, ju njoftojmë se më shumë informata për punën e Avokatit të Popullit, në mënyrë kronologjike sipas viteve dhe sipas fushave, në gjuhën angleze, mund të gjeni në ueb-faqen [www.ombudsman.mk](http://www.ombudsman.mk), përkatësisht në raportet Vjetore dhe të Posaçme të Avokatit të Popullit, të cilët përfshijnë segment të gjerë të rekomandimeve të përmendura.

## **II . Për institucionin Avokat i Popullit**

Avokati i Popullit, në përputhje me nenin 77 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, vëmendje të veçantë i kushton parimit të mosdiskriminimit dhe

përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të bashkësive në organet shtetërore, organet e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe institucionet e shërbimet publike. Kjo dispozitë kushtetuese është sanksionuar në Ligjin për Avokatin e Popullit ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 60/03,114/09,181/16,189/16 dhe 35/18) dhe me të është vendosur kompetenca e Avokatit të Popullit përmes Seksionit të veçantë për monitorimin e gjendjeve dhe mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe përfaqësimin e drejtë dhe adekuat të bashkësive, të ndërmerr masa dhe veprime për mbrojtjen e parimit të mosdiskriminimit në organet shtetërore në nivel qendror dhe lokal, si dhe në institucionet dhe shërbimet publike – parime të cilat janë në përputhje me nenin 2 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, dhe të cilat janë në lidhje të ngushtë me Rekomandimet e Përgjithshme të KERJ.

Është e nevojshme të theksohet se, Avokati i Popullit vepron sipas parashtresave të parashtruara nga ana e qytetarëve, të cilat duhet t'i përmbaj rrethanat, faktet dhe provat mbi të cilat janë prezantuar të dhënat për cenimin e të drejtës dhe njëkohësisht ai mund të veproj edhe me iniciativë të vet për cenimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore të një numri të madh të qytetarëve, personave të mitur, të pamundur, personave me aftësi të kufizuar, për çka nuk nevojitet pëlqim nga personi/personat të drejtat e të cilëve janë cenuar. Gjatë paraqitjes së parashtresës, gjuha në të cilën parashtrohet e njëjta nuk është pengesë për komunikim me Avokatin e Popullit. Me të mund të komunikohet përveç në gjuhën dhe alfabetin zyrtar edhe në gjuhën dhe alfabetin e cilësdo qoftë bashkësi e cila jeton në Republikën e Maqedonisë, ndërsa Avokati i Popullit u përgjigjet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe alfabetin të cilin e përdor parashtruesi i parashtresës. Parashtresa me të cilën inicohet procedura nuk ka formë të përcaktuar, e njëjta mund të paraqitet me shkrim, gojarisht në procesverbal ose përmes rrugës elektronike. Parashtruesi i parashtresës është i çliruar nga pagesa e taksave për procedurën para Avokatit të Popullit.

Nëse gjatë veprimit, Avokati i Popullit konstaton se me veprime ose akte të caktuara ekziston diskriminimi, mund të jep rekomandim, propozim, mendim dhe sugjerim deri te organet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe deri te organet dhe organizatat me autorizime publike. Organet duhet t'i respektojnë rekomandimet, propozimet, mendimet dhe sugjerimet e Avokatit të Popullit ndërsa nëse të njëjtat nuk respektohen Avokati i Popullit ka mundësi ta njoftoj ministrin kompetent, Qeverinë ose Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, me ç'rast në mënyrë

plotësuese mund të ekspozoj në kritikë publike çdo organ kompetent ose person zyrtar i cili ka kryer cenim të të drejtës së qytetarit/qytetarëve.

Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Avokatin e Popullit të vitit 2009, u formua Seksioni për mbrojtjen nga diskriminimi dhe përfaqësimin e drejtë dhe adekuat, qëllimi i të cilit është të veproj konform kompetencave ligjore gjatë mbrojtjes së të drejtave kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve nga ana e organeve të administratës shtetërore, organizatat të cilat kanë autorizime publike, organet e vetëqeverisjes lokale dhe institucionet dhe shërbimet publike, me paraqitjen e parashtresave. Ky Seksion bën promovimin e institucionit Avokat i Popullit në fushën e mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, përmes publikimit të broshurave dhe fletëpalosjeve, publikimit të raporteve të posaçëm, si dhe prezantimit të gjendjeve përmes mjeteve të informimit publikë dhe ngjashëm.

Avokati i Popullit, këto kompetenca ligjore të Seksionit i realizon përmes bashkëpunimit dhe komunikimit me institucionet kompetente të shtetit, në bashkëpunim me sektorin civil dhe me institucionet e tjera (partnere) vendore dhe të huaja, përfshirë edhe institucionet e Ombudsmanëve të rajonit dhe më gjerë, të cilët punojnë në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të qytetarëve, si dhe në mbrojtjen nga diskriminimi.

### **III. Përshkrimi i gjendjes**

Avokati i Popullit në mënyrë aktive e monitoron veprimin e organeve kompetente sipas kërkesave të qytetarëve, në lidhje me realizimin dhe mbrojtjen e të drejtës së mosdiskriminimit dhe respektimit të parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të bashkësive, me ç'rast deri te ministritë dhe organet e tjera të administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe institucionet e shërbimet publike i dërgon të gjitha hulumtimet dhe raportet e tij për aktivitetet e zbatuara e që kanë të bëjnë me parimet e lartpërmendura, në të cilat përveç gjendjeve të konstatuara në fusha të ndryshme janë dhënë rekomandime dhe udhëzime për avancimin dhe respektimin e barazisë së qytetarëve dhe parandalimin e diskriminimit.

Me këtë rast, dëshirojmë të potencojmë se ekipi evaluator i KERJ, i cili e kryen monitorimin për rrethin e pestë, në mënyrë tejet të suksesshme i ka identifikuar dobësitë dhe mangësitë e shoqërisë maqedonase të cilat, në vazhdimësi, tanimë më shumë vjet janë theksuar edhe në Raportet vjetore të Avokatit të Popullit.

## **PËRGJIGJJA E LISTËS SË REKOMANDIMEVE**

**Shënim:** Rrjedhimisht me rekomandimet e dhëna në Raportin e rrethit të pestë të monitorimit të Republikës së Maqedonisë, në këtë Informatë Alternative, do të bëjmë përpjekje të japim interpretim individual për gjendjet e rekomandimeve për të cilat kemi njohuri, përkatësisht për ato rekomandime për të cilat edhe ne si institucion, mbi bazë të kompetencave tona kemi udhëhequr procedura të caktuara dhe e kemi ndjekur gjendjen për zbatimin dhe progresin e tyre.

Sa u përket rekomandimeve të cilat nuk do të përfshihen me këtë Informatë Alternative, Avokati i Popullit konsideron se përgjigjja për ato rekomandime dhe progresi eventual në lidhje me të njëjtat mund të kërkohet para institucioneve dhe organeve të tjera me të cilat kanë të bëjnë të njëjtat, apo, tek trupat rregullator dhe të revizionit të cilët kanë obligim ligjor ta monitorojnë gjendjen momentale.

Rekomandim, pika 2:

(&10) Në lidhje me rekomandimin me numrin rendor 2 të Listës së rekomandimeve, i cili është në kontekst të Rekomandimit të përgjithshëm nr. 7, Avokati i Popullit njofton se nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë është formuar Grupi i gjerë ekspert i punës për përpilimin e tekstit të ri të Propozim-Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Në këtë Propozim–Ligj janë përfshirë: orientimi seksual dhe identiteti gjinor si baza të diskriminimit, me çka përveç 19 bazave të deritanishme, lista është zgjeruar edhe me këto dy baza, me ç'rast neni 3 i mëparshëm në të cilin ishin parashikuar të gjitha bazat ligjore për ushtrimin e diskriminimit është transferuar në nenin 5 të Propozim-Ligjit.

Me Propozim-Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, në nenin 12 parashikohet segregacioni, ndërsa në nenin 4 “Lista e nocioneve” në paragrafin 1 pikën 8 dhe 9 parashikohet “diskriminimi sipas asociacionit” dhe “diskriminimi sipas perceptimit”.

Mundësia e organizatave qytetare ose shoqatave dhe asociacioneve për angazhim dhe përfshirje në procedura qytetare dhe procedura gjyqësore është parashikuar me nenin 40 të Propozim-Ligjit, si edhe mundësia e dhënë shtesë e cila është parashikuar me nenin 35 (action popularis).

Promovimi për barazi dhe parandalim të diskriminimit të Komisionit për Mbrojtje nga Diskriminimi, është parashikuar me nenin 21 të këtij Propozim-Ligji, ndërsa promovimi i këtyre dy parimeve, të cilët janë parashikuar edhe me nenin 9 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, nuk ka qenë fare kontestues, por sipas Avokatit të Popullit, bëhet fjalë për interpretim të selektuar të dispozitave të caktuara, varësisht nga njohja e legjislacionit vendas dhe ndërkombëtar të njerëzve kryesorë të cilët administrojnë me organet e pushtetit dhe ndjenjës së tyre të përfshirjes në këtë çështje.

Rekomandim, pika 3:

(&14) Me Kapitullin III “Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi” nga Propozim-Ligji i ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, ndërrohet tërësisht statusi i Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kështu që me nenin 14 parashikohet që ky trup të jetë organ i pavarur dhe autonom, me cilësi të personit juridik dhe me buxhet të veçantë. Njëkohësisht, theksojmë se me nenet e tjerë të Propozim-ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi është parashikuar financimi i Komisionit, përbërja e komisionit, procedura e zgjedhjes dhe statusi i komisionarëve, shkarkimi dhe ndërprerja e funksionit, kompetencat e tyre, ndërsa si risi është inkorporimi i shërbimit profesional i cili do t'i zbatoj punët administrative. Me këtë ndryshim tejkalohet problemi i deritanishëm i Komisionit ekzistues i cili punonte dhe mbante *ad hoc* mbledhje, përkatësisht komisionarët nuk ishin punësuar si profesionistë dhe nuk kishin shërbim profesional për kryerjen e punëve administrative.

Dëshirojmë të theksojmë se Propozim-Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi është harmonizuar në nivel nacional, me të gjitha organet dhe organizatat relevante, ndërsa në të njëjtin janë përfshirë edhe rekomandimet e organizatave relevante ndërkombëtare dhe Komisionit të Venecias, i cili dha mendim pozitiv. Njëherësh, potencojmë se derisa po përgatitet kjo Informatë Alternative, Propozim-Ligji është në procedurë të Kuvendit dhe sipas pritshmërive do të duhej të miratohet kah fundi i këtij viti.

Rekomandim, pika 4 dhe 5:

(&32) dhe (&33) Sa i përket problemit në rritje të gjuhës/transfobike raciste dhe homofobike, Avokati i Popullit konsideron se nevojitet edukim gjithëpërfshirës të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve, ndërsa plotësisht është dakord me rekomandimin e KERJ, lidhur me marrjen e masave të organeve kompetente me inkorporimin e dispozitave përkatëse ndëshkuese në ligjet e theksuar, ndëshkime të cilat do të kishin dedikim parandalues, përkatësisht të njëjtët do të aplikoheshin në mënyrë joselektive dhe lartësia e tyre do të shkaktonte efekt shtesë financiar dhe psikologjik tek kryerësit e veprave të këtilla.

Në praktikën e deritanishme, pranë Avokatit të Popullit nuk është paraqitur numër i madh i lëndëve të cilat kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes, megjithatë, lëndët e këtilla ekzistojnë, prej të cilave një pjesë janë të hapura sipas iniciativës së Avokatit të Popullit, ndërsa disa sipas denoncimeve të paraqitura nga shoqatat qytetare. Nga procedimi i lëndëve, Avokati i Popullit konstatoi se shpërfillen mekanizmat e mbrojtjes nga ana e shtetit, përkatësisht se mbrojtja kërkohet vetëm përmes trupave pseudo-gjyqësor siç është Avokati i Popullit dhe Komisioni për Parandalimin e Diskriminimit, të cilët mund të prevenojnë dhe të ofrojnë mbrojtje të pjesshme, por nuk mund të mundësojnë kompensim përkatës dhe satisfaksion të viktimave ose kthimin në pozitën e parë me qëllim të mbrojtjes së plotë. Avokati i Popullit, përmes komunikatave, paraqitjeve në media, si dhe në Raportet vjetore e vë në dukje ekzistimin e gjuhës së urrejtjes. Në këtë kontekst, gjatë viteve të fundit, konstaton gjuhë të urrejtjes gjithnjë e më të madhe e që është shumë shqetësuese, prandaj dhe publikisht u bëri apel institucioneve që ta ndërpresin një gjë të këtillë duke e vënë në dukje përhapjen e gjuhës së këtillë të urrejtjes në paraqitjen e personave publikë, por edhe në rrjetet sociale, për përplasjen me kundërshtarët politikë, por edhe mbi bazë etnike e që, nga ana tjetër, e trason rrugën drejt dhunës.

Rekomandim, pika 8:

(&58) Avokati i Popullit me shqetësim konstaton se, vite me radhë, në Raportet vjetore vërehet dukuri e zbatimit jocosor të zbatimit të parimit kushtetues të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të bashkësive më të vogla. Së këtejmi, nuk ka ndryshime të dukshme në implementimin e aplikimit të këtij parimi, sidomos kur janë në pyetje pjesëtarët e bashkësive më të vogla të cilët nuk i përkasin

bashkësisë maqedonase dhe shqiptare dhe sistematizimit të tyre në vende udhëheqëse të punës. Konsiderojmë se kjo gjendje i referohet ndarjes së pushtetit midis dy blloqeve, përkatësisht partive të cilat fitojnë shumicën e votave dhe të cilat kanë numër më të madh të përfaqësuesve në Parlament, me ç'rast bashkësitë më të vogla, të cilat participojnë në pushtet, megjithatë janë lënë në margjina dhe marrin numër minimal të pozitive udhëheqëse. Avokati i Popullit konsideron se vendosja e këtillë ndikon që ndarja e funksioneve udhëheqëse të bëhet vetëm përmes çelësit partiak, në të gjitha pozitat e administratës publike, me çka humb mundësia e krijimit të kuadrit kualitativ dhe profesional në administratë (merit sistemi).

Duke e pasur parasysh gjendjen e këtillë, Avokati i Popullit e monitoron vazhdimisht pozitën dhe gjendjen e të gjitha bashkësive etnike në administratën publike. Në këtë kontekst, dërgoi sugjerim dhe rekomandim se është e nevojshme që institucionet të marrin masa dhe aktivitete konkrete për respektimin e detyrueshëm dhe implementimin real të parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat të pjesëtarëve të të gjitha bashkësive, si dhe përforcimin e aktiviteteve për implementimin e këtij parimi, sa u përket vendeve udhëheqëse të punës të pjesëtarëve të bashkësive të cilat janë në numër më të vogël. Rekomandimet e Avokatit të Popullit çojnë në drejtim të respektimit të planeve vjetore për punësim, të cilat institucionet e kanë për detyrë t'i përgatisin për çdo vit të ardhshëm dhe të cilat miratohen nga ministria përkatëse dhe kanë për qëllim të arrihet përfaqësimi përkatës i të gjitha etnive gjatë realizimit të të drejtës për punë në sektorin publik.

Rekomandim, pika 9:

(&67) Avokati i Popullit pajtohet tërësisht me rekomandimin e KERJ për zgjidhjen e gjendjes së vështirë me banimin e romëve, mes tjerash, edhe përmes sigurimit të numrit të mjaftueshëm të banesave/shtëpive sociale për pjesëtarët e bashkësisë vulnerable romë. Në këtë drejtim, me iniciativë të tij, duke e ndjekur gjendjen e këtyre familjeve, si dhe familjeve vendbanimet e improvizuara të të cilëve ishin shembur në vendin e quajtur “Nën Kala”, ndërkaq duke i marrë parasysh gjendjet dhe kapacitetet e vendosjes së personave – të pastrehë në “Çiçino Sello”, nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale kërkoi të informohet se në ndërkohë a është gjetur zgjidhja për zgjidhjen afatgjatë të problemit me personat e pastrehë nga “Nën Kalaja” e Shkupit, ku për momentin janë vendosur këto familje dhe çfarë ndihme dhe mbështetje u është

siguruar. Në këtë kontekst, kërkoi të informohet se a ka hapësira të lira (dhoma) për vendosjen e familjeve nga Gazi Baba në Qendrën për persona të pastrehë – “Çiçino Sello”, aktualisht sa ka kapacitete të lira dhe sa familje mund të vendosen, këtyre familjeve a u është ofruar ndonjë zgjidhje për vendosje, çfarë zgjidhe dhe sa familje kanë pranuar me ç’rast, nëse nuk kanë pranuar, të theksohen shkaqet për një gjë të këtillë. Po ashtu, Avokati i Popullit sugjeroi që të merret parasysh se bëhet fjalë për kategori vulnerable të qytetarëve, të cilëve u është vështirësuar qasja deri te të drejtat nga fusha të ndryshme, persona të cilët janë pa shtëpi, pa dokumente, dhe në këtë mënyrë edhe pa mundësi për shfrytëzimin e çfarëdo të drejtash të mbrojtjes sociale. Kjo do të thotë se rasti është shumë kompleks, dhe nuk është problem vetëm gjetja e vendbanimit përkatës për këta persona por edhe nisja e një sërë procedurash, para së gjithash, për sigurimin e dokumentacionit për verifikimin e identitetit të tyre dhe rrjedhimisht edhe procedura të tjera, gjë që e imponon nevojën e përfshirjes dhe bashkëpunimit të më shumë organeve/organizatave për gjetjen e përgjigjes përkatëse të gjendjes në të cilën gjenden.

Sipas Avokatit të Popullit, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale si organ nën kompetencën e të cilës është mbrojtja e personave në rrezik social duhet t’i ketë parasysh këto gjendje të konstatuara të këtilla edhe konform kompetencave, ndërsa me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së këtij grupi vulnerabil të qytetarëve, të inicioj shqyrtim multi-sektorial dhe multi-resorial të problemit/eve, me qëllim të gjetjes së zgjidhjes më të përshtatshme për të ta. Njëkohësisht, të ndërmerren masa me qëllim të shqyrtimit të kapaciteteve në dispozicion dhe mundësive për zgjidhje përkatëse afatgjate, duke e marrë parasysh se për momentin vendosja e vetme e personave të pastrehë, madje edhe ajo që u ofrohet këtyre familjeve, është Qendra e pranimi – “Çiçino Sello”, ndërsa konform përgjigjes së Qendrës kapaciteti është thuaja se i plotësuar. Gjithashtu, kërkoi dhe sugjeroi të analizohet tërësisht gjendja në Qendrën e pranimi të personave të pastrehë, i nga aspekti i kapaciteteve të vendosjes, kushteve, mundësive për realizimin e të drejtave, në përputhje strukturën e moshës së personave, aspektit të sigurisë dhe ngjashëm, kështu që edhe arsyet për shkak të të cilave refuzohet vendosja në këtë Qendër dhe rrjedhimisht të ndërmerren masa adekuate. Sipas Avokatit të Popullit, vendosja e personit/ave të pastrehë në Qendrën për persona të pastrehë duhet të jetë me karakter të përkohshëm, dhe në këtë drejtim sugjeroi të ndërmerren të gjitha masat, me qëllim që këtyre personave t’u sigurohet



zgjidhje e përhershme sa i përket çështjes që ka të bëjë me banimin, t'u jepet ndihmë dhe mbështetje, me çka edhe ata vet të mund të kontribuojnë, përkatësisht t'i rrisin kapacitetet e tyre të jetesës dhe ekzistencës.

Rekomandim, pika 10:

(&69) Në lidhje me aksesin dhe sigurimin e konsultimeve të rregullta dhe complete gjinekologjike në Komunën Shuto Orizarë, Avokati i Popullit gjatë periudhës së kaluar ndërmori aktivitete duke i sugjeruar Ministrisë së Shëndetësisë nevojën e punësimit të gjinekologut në ambulancën e Shuto Orizarës, gjë që rezultoi nga puna jonë me lëndë. Pas sugjerimit tonë në vitin 2017, Ministria e Shëndetësisë hapi ambulancë në këtë komunë në të cilën u punësua një mjekë specialiste gjinekologe e cila punon edhe tani.

Në lidhje me shërbimet prenatale, Avokati i Popullit dërgoi rekomandim në ministrinë kompetente, që në mënyrë adekuate ta zbatoj "Programin qeveritar për nëna dhe fëmijë", konform të cilit kërkuam edukim dhe promovim adekuat për njoftimin e shfrytëzuesve. Informacionet tona janë se kjo problematikë akoma nuk është zbatuar plotësisht në përputhje me përcaktimet e Programit të cituar dhe për këtë shkak Avokati i Popullit vazhdon ta monitoroj zbatimin dhe implementimin në terren. Potencojmë se deri në fund të vitit 2018, Avokati i Popullit planifikon të organizoj punëtori edukative me pjesëmarrjen e organizatave joqeveritare romë dhe personave shfrytëzues, si dhe me përfaqësues të institucioneve shëndetësore.

Rekomandim, pika 11:

(& 72) Sa i përket rekomandimit të referimit joadekuat të fëmijëve romë në institucionet arsimore, të cilët janë dedikuar për nxënësit me aftësi të kufizuar mendore, gjatë viteve të kaluar, Avokati i Popullit vazhdimisht e vinte në dukje ekzistimin e këtij problemi. Informatat tona për këtë problematikë, gjatë periudhës së kaluar, janë se Ministria kompetente ka ndërmarrë hapa të caktuar për tejkalimin e problemit ekzistues. Avokati i Popullit konsideron se ende ekzistojnë mundësi për keqpërdorime të caktuara nga ana e Komisionit kompetent i cili e bën seleksionimin, para së gjithash, për shkak të asaj se në të nuk është përfshirë person pjesëtar i bashkësisë, i cili e flet gjuhën e komunitetit. Në këtë segment, Avokati i Popullit me rekomandim i sugjeroi këtij organi se duke e marrë parasysh se mos-zotërimi i gjuhës, gjatë vlerësimit nga ana e anëtarëve të Komisionit, në rast të caktuar, mund të

interpretohet si aftësi e kufizuar, kështu që në dëm të fëmijës, në vend që të dërgohet në shkollë të rregullt, dërgohet në shkollë të posaçme. Rrjedhimisht me këtë që u tha, Ju njoftojmë se gjatë 2 vjet e gjysmë nuk kemi pranuar parashtresë e cila ka të bëjë me këtë problematikë, ndërsa Avokati i Popullit monitorimin e gjendjes me fëmijët romë dhe në përgjithësi të fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkollat fillore të posaçme do ta planifikoj si aktivitet në plan-programin e tij të punës.

Rekomandim, pika 13:

(&76) Gjetja e zgjidhjes, në lidhje me problemin e mos-regjistrimit në Librin amzë të të lindurve, veçanërisht e fëmijëve të bashkësisë etnike rome, gjatë viteve të fundit, ishte njëri nga prioritetet e Avokatit të Popullit, për çka në vazhdimësi i kushtojmë vëmendje. Është e pakontestueshme se këta fëmijë nuk kanë qasje në mbrojtjen shëndetësore, arsim, mbrojtje sociale dhe ngjashëm, ndërsa kur prindërit e tyre paraqesin kërkesë për regjistrim plotësues në Librin amzë të të lindurve ballafaqohen me pengesa për shkak të pamundësisë që t'i paraqesin dokumentet e nevojshme si provë për përcaktimin e kohës dhe vendit të lindjes, me çka i nënshtrohen rrezikut social dhe shëndetësor, me pasoja serioze për jetën e tyre. Duke e pasur parasysh gjendjen e këtyllë, Avokati i Popullit deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë paraqiti Iniciativë për ndryshimin e Ligjit për procedurë jashtëkontestimore, me propozim që të parashikohet Kapitull i ri – Procedurë për përcaktimin e kohës dhe vendit të lindjes nga ana e gjykatës kompetente, me çka do të përcaktohet edhe afati në të cilin gjykata do ta miratoj vendimin, si dhe ndryshimin e Ligjit për evidencën amë, në atë mënyrë që regjistrimi do të parashikohet në bazë të vendimit gjyqësor, iniciativë e cila është pranuar nga ana e Qeverisë së RM-së. Njëherësh, Avokati i Popullit e monitoron gjendjen me aktivitetin e Drejtorisë për Udhëheqjen e Librave Amzë për paraqitjen e fëmijëve/personave të peregjistruar në Librin amzë të të lindurve, i cili zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe shoqatave dhe organizatave joqeveritare (qytetare).

Rekomandim, pika 18:

(&84) Për dallim nga vitet e kaluar, kur Avokati i Popullit konstatonte cenim të të drejtave të romëve në lirinë e lëvizjes përmes pikave kufitare, e që është shënuar në raportet vjetore të viteve: 2014, 2015 dhe 2016, në vitin 2017 mbi këtë bazë nuk është paraqitur asnjë parashtresë.

Konsiderojmë se kjo i referohet rekomandimeve të dërguara paraprakisht të Avokatit të Popullit deri te ministria kompetente dhe Informatës drejtuar Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, disa aktgjykimeve gjyqësore kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe për shkak të trajnimeve të zbatuara të nëpunësve policor kufitarë të cilat janë zbatuar nga ana e Avokatit të Popullit dhe nga ekspertë relevantë të tjerë të angazhuar përmes OSBE gjatë viteve 2016 dhe 2017. Në këtë drejtim, Ju njoftojmë se kjo çështje u shqyrtua edhe në mbledhjen e Komisionit të Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, në të cilën u miratuan rekomandimet nga Konferenca e organizuar nga Avokati i Popullit në bashkëpunim me Komitetin e Helsinkit dhe Misionit të OSBE në Shkup, me temë: “Kufizimi i të drejtës së lëvizjes së romëve”. Njëri nga rekomandimet është zgjidhja sistemore e këtij problemi, dhe në këtë drejtim Avokati i Popullit mori pjesë në grupin e punës i cili përgatiti ndryshime përkatëse të Ligjit për policinë dhe Ligjin për kontroll kufitar, të cilat propozime iu dërguan Ministrisë kompetente, për çka janë parashikuar aktivitete dhe mbajtje të takimeve në muajin shtator të vitit 2018.

Rekomandim, pika 17:

(& 89) Në lidhje me rekomandimin e dhënë, autoritetet të mundësojnë plotësimin e vendeve të zbrazëta të punës në zyrën e Avokatit të Popullit, Ju njoftojmë se gjatë vitit 2018 zbatoi edhe Konkurs publik me të cilin janë plotësuar 8 vende vakante në zyrën e Avokatit të Popullit në Shkup, me çka numri i të punësuarve aktualisht, përfundimisht me muajin gusht, është 79 të punësuar nga 134 vende pune të parashikuara në përputhje me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës. Deri në fund të vitit 2018 parashikohet zbatimi edhe i një Konkursi publik për plotësimin e 3 pozicioneve të punës, me çka numri do të arrijë deri në 82. Rrjedhimisht me këtë numër të realizuesve të sapo-pranuar presim që Avokati i Popullit, në masë më të madhe, do të mund të veproj konform kompetencave të reja dhe të zgjeruara ligjore dhe në këtë mënyrë edhe qytetarëve do t'u japë të drejta nga institucionet e sistemit.

#### IV. **Konkluzion**

Në bazë të kësaj që u tha më lartë, mund të konstatohet se ekziston progres sa u përket rekomandimeve të dhëna të KERJ, megjithatë konsiderojmë se, edhe në të ardhmen, autoritetet duhet t'i monitorojnë plotësisht dhe në mënyrë të pakushtëzuar

të njëjtat, para së gjithash në drejtim të përafrimit të legjislacionit vendas me atë ndërkombëtar i cili parashikon fushëveprim të gjerë të lirive dhe të drejtave të qytetarëve, si dhe mbrojtjen e tyre nga diskriminimi dhe pabarazia.

Avokati i Popullit, me këtë Informatë Alternative, e cila buron nga fushëveprimi i veprimit të tij, ofron pasqyrën e gjendjeve momentale në shtet të cilat kanë të bëjnë me Raportin e KERJ për rrethin e pestë të monitoringut.